

SigmaInteralbanian VIENNA INSURANCE GROUP sh.a.

**Pasqyrat Financiare për raportim specifik
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(me raportin e audituesit të pavarur bashkëlidhur)**

Përbajtja

Faqe

Raporti i audituesve të pavarur

Pasqyrat financiare për raportim specifik:

Pasqyra e pozicionit finansiar për raportim specifik	1
Pasqyra e fitimit ose e humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse për raportim specifik	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital për raportim specifik	3
Pasqyra e fluksit të parnës për raportim specifik	4
Shënimë mbi pasqyrat financiare për raportim specifik	5-39
Skedule suplementare	i-ii

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët e SigmaInteralbanian Vienna Insurance Group sh.a

Raport mbi auditimin e pasqyrave financiare për qëllim specifik

Opinioni

Në kemi audituar pasqyrat financiare të SigmaInteralbanian Vienna Insurance Group sh.a ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2016, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parashës për vitin që mbylli me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur parasesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2016, che rezultatin e saj financiar dhe të fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur më atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë audituar nga një tjetër auditues i cili ka lëshuar një opinion të pamodifikuar më 19 prill 2016.

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tonë sipas këtyre standardeve janë përshtkuar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjëstë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkosat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkosa dhe me Kodin BSNEPK. Ne besojmë se evidencia e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Baza e kontabilitetit dhe kufizimi në përdorim dhe shpërndarje

Ne tërheqim vëmendjen për Shënim 6.b të pasqyrave financiare, i cili përshtkuani bazat e kontabilitetit. Pasqyrat financiare janë përgatitur për arsyen që Shoqërinë të përbushur kërkosat e kuadrit ligjor mbikqyrës të sigurimeve në Shqipëri. Rrjedhimisht, pasqyrat financiare mund të mos janë të përshtatshme për përdorime të tjera. Raporti ynë i adresohet vetëm Shoqërisë dhe Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare ("AMF") dhe nuk duhet të përdoret nga palë të tjera përvëç Shoqërisë apo AMF. Opioni ynë nuk është modifikuar për sa i përket kësaj çështjeje.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe Këshillit Mbikqyrës për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontolle të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar afitësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përvëç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përvëç sa më sipër.

Këshillit Mbikqyrës është përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivitet tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nësë pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siçuria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, priten që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtimit ose gabimit, hartojmë dha kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftuashme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mosbulimit të një anomali materiale si rezultat i mashtimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përashtime të çëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njoftje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrëthanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojme përshtatshmérinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmérinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmérinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësish, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, të cilat mund të hedhin dyshime të mëdha për attësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimitarë. Nëse arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në reportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e reportit tonë. Megjithatë, ngjärje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimitarë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përbaltjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shqejuese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrijnë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe Këshillin Mbikëqyrës të Sigmainteralbanian Vienna Insurance Group sh.a, përvetë tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë nconjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raportet për agjensitë rregullatore - kërkesa e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Republikës së Shqipërisë për marzin e Aftësisë Paguese dhe Aktiveve në Mbulim të Rezervave Teknike

Në përputhje me kërkuesat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, ne kemi lexuar skedulet suplementare shoqëruese të marzhit të Aftësisë Paguese dhe Aktiveve në Mbulim të Rezervave Teknike ("Skedule Suplementare"). Këto Skedule Suplementare të përgatitura nga Drejtimi nuk janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare për qëllim specifik. Informacioni finansiar historik, prezantuar në Skedule Suplementare shoqëruese i përgatitur nga Drejtimi, është konsistent, në të gjitha aspektet materiale, me informacionin finansiar vjetor të paraqitur në pasqyrat finançare për qëllim specifik të Shoqërisë në datë 31 dhjetor 2016. Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e Skeduleve Suplementare, në përputhje me Ligjin nr. 52/2014 "Mbi veprimitarinë e sigurimit dhe risigurimit".

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega Shqipëri

Ernst & Young Certified Auditor
24 mars 2017
Tiranë, Shqipëri

Mario Vangjel
Ekspert Kontabël i Regjistruar

M. Vangjel



SigmaInteralbanian Vienna Insurance group sh.a.

Pasqyra e Pozicionit Financiar për raportim specifik

(Të gjitha shuanot janë shprehur në Lek' 000, përvetëse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënimë	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
AKTIVET			
Mjete monetare dhe ekivalente me to	11	164,717	60,111
Depozita me afat me banka	12	823,531	956,631
Bono Thesari	13	1,045,313	1,034,084
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera	14	175,369	191,043
Kostot e shtyra të marjes në sigurim	15	235,194	207,318
Aktive të risigurimit	16	1,233,488	1,474,157
Parapagim tatum mbi fitimin	17	35,264	35,264
Tatum i shtyrë	18	-	13,936
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara	19	293,147	307,913
Ndërtesa të investuara	20	112,066	112,066
Aktive të tjera	21	155,238	128,999
Aksione në shoqëri të lidhura	22	211,206	211,206
TOTALI I AKTIVEVE		4,493,533	4,732,728

DETÝRIMET

Detyrimet për humbjet dhe shpenzimet e arhustimit të humbjeve	23	1,399,782	1,632,625
Rezerva e primit të pasituar	24	1,002,242	990,716
Detyrime të tjera me shtetin	25	32,061	15,298
Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera	26	986,017	1,006,024
Detyrime tatumore të shtyra		9,589	-
TOTALI I DETÝRIMEVE		3,429,691	3,644,663

KAPITALI

Kapitali themeltar	27	498,213	498,213
Rezerva të riskut të sigurimit	27	171,792	171,792
Rezerva e rivlerësimit	27	78,192	82,170
Rezerva e bashkimit	27	437,207	437,207
Humbja e imbartur		(121,563)	(101,317)
TOTALI I KAPITALIT		1,063,842	1,088,065
TOTALI I DETÝRIMEVE DHE KAPITALIT		4,493,533	4,732,728

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 39 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra janë miratuar nga Drejtuesit e Shoqërisë në 23 Mars 2017.



Ilir Elmazi
Drejtësor Finans

SigmaInteralbanian Vienna Insurance group sh.a.

Pasqyra e fitimit ose e humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse për raportim specifik
(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek' 000, përvçese kur përcaktohen ndryshej)

		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor	
	Shënie	2016	2015
Prime të shkruara bruto	28	2,080,063	2,134,516
Ndryshimi në rezervën për primet e pasituara	24	(51,554)	(94,689)
Prime të ceduara risiguruesve	29	(912,496)	(1,089,706)
Të ardhura neto nga primi i sigurimit		1,116,013	950,121
 Të ardhura të tjera	30	5,087	1,035
Të ardhura neto		1,121,100	951,156
 Dëme të paguara	23	(574,409)	(490,562)
Ndryshimi në rezervën e dëmeve të sigurimit dhe risigurimit	23	43,532	(143,041)
Dëme të sigurimit neto		(530,877)	(633,603)
 Kostot e marjes në sigurim	31	(566,422)	(537,841)
Ndryshimi në kostot e marjes në sigurim.net		27,874	4,015
Shpenzime administrative	32	(325,840)	(335,379)
Të ardhura nga komisionet e risigurimit		438,566	520,123
Shpenzime të tjera sigurimi	33	(215,907)	(89,816)
Shpenzime operative		(641,749)	(438,897)
 Të ardhura nga interesë	34	73,639	48,854
Shpenzime financiare		(17,803)	(18,571)
Të ardhura nga kurset e këmbimit neto	35	(5,029)	4,661
Të ardhura nga dividenti		-	75,813
Të ardhura financiare neto		50,807	110,757
 Humbje para tatimit		(699)	(10,587)
Shpenzimi tatim fitimi	36	(23,524)	(19,651)
 Humbja e vitit		(24,223)	(30,238)
 Rivlerësimi i aktiveve të trupëzuara		4,679	4,679
Taksa mbi të ardhurat përmbledhëse të tjera		(702)	(702)
Të ardhura përmbledhëse të tjera neto nga taksa		3,977	3,977
 Totali i humbjes përmbledhëse të vitit		(20,246)	(26,261)

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 39 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SigmaInterAlbanian Vienna Insurance group sh.a.
Pasqyra e lëvizjeve në kapital për raportim specifik
 Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015
(Të gjitha shumat janë shprehur ne Lek '000, përvizosur kur përcaktohet natyrisht)

	Kapitali themeltar	Rezerva e sigurimit	Rezerva e bashkimit	Rezerva e rivlerësimit	Humbja e mbartur	Totali
Gjendja më 1 janar 2015	498,213	171,792	437,207	86,147	(75,056)	1,118,303
Totali i të ardhurave përmbledhëse të vitiit	-	-	-	-	(30,238)	(30,238)
Humbja e vitiit	-	-	-	-	3,977	-
Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatimi	-	-	-	(3,977)	-	-
Totali i të ardhurave përmbledhëse të vitiit	-	-	-	(3,977)	(26,261)	(30,238)
Transaksione me pronarët të regjistruar direkti në kapital	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	498,213	171,792	437,207	82,170	(101,317)	1,088,065
Gjendja më 1 janar 2016	498,213	171,792	437,207	82,170	(101,317)	1,088,065
Totali i të ardhurave përmbledhëse të vitiit	-	-	-	-	(24,223)	(24,223)
Humbja e vitiit	-	-	-	-	3,977	-
Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatimi	-	-	-	(3,977)	-	-
Totali i humbjeve përmbledhëse për vitiit	-	-	-	(3,977)	(20,246)	(24,223)
Transaksione me pronarët të regjistruar direkti në kapital	-	-	-	-	-	-
Totali i kontributeve nga dhe shpërndurë tek pronarët	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	498,213	171,792	437,207	78,192	(124,563)	1,063,842

Shënimet shoqërore në faqet 5 deri 39 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SigmaInteralbanian Vienna Insurance group sh.a.
Pasqyra e fluksit të parashë për raportim specifik
(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek' 000, përvetësuar kur përcaktohet ndryshe)

Shënim	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor	
	2016	2015
Humbje para tatim fitimit	(24,223)	(30,238)
Fluksi i parashë nga aktivitetet operative		
<i>Rregullime per::</i>		
Amortizimin	19	24,782
Nxjerrja jnshtë përdorimit të aktiveve të qëndrueshme	19	-
Provigion per borxhin e keq	14	4,588
Rënja në vlerën e drejtë në ndertesa e investuara	20	-
Humbja nga zhvlerësimi i aktiveve të tjera		-
Shpenzime interesi		-
Te ardhura nga interesi		(73,639)
		(68,492)
		6,660
Ndryshimi në:		
-Rezervën për primet e pasituara		11,526
-Aktivet e risiguruesit		240,670
-Kostot e shtyra të matrjes ne sigurim		(27,875)
-Rezervën e dëmeve		(232,843)
-Detyrimin e taksave te shtyra		9,589
-Aktivin e taksave te shtyra		13,935
-Ndertesa e investuara		-
-Të arkëtueshmet për sigurim dhe të tjera		11,086
-Aktive të tjera		(26,239)
-Të pagueshme për sigurim e të tjera		(20,007)
-Detyrime të tjera		16,763
		(3,395)
		444,013
Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative		
Interes i paguar		-
Tatim fitimi i paguar		-
		(18,571)
Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative		425,442
Flukset monetare nga aktivitetet investuese		
Interes i arkëtar		72,495
Blerje aktivesh të trupuzuara dhe të patruçzuara	19	(10,016)
Zvogëlim në depozitat me afat		121,393
Blerje e bonove të thesarit		(7,379)
Rritje në investime sipas metodës së kapitalit		-
		176,493
Flukset monetare të përdorura në aktivitetet investuese		(518,478)
(Ujje)/rritje neto në mjetet monetare dhe ekuivalente me to		104,606
Mjete monetare dhe ekuivalente më 1 janar		60,111
		164,717
Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 dhjetor	11	60,111

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 39 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacione të përgjithshme

"SigmaInteralbanian VIENNA INSURANCE GROUP" sh.a ("Shoqeria" ose "SIVIG" e njohur më parë si Sigma VIENNA INSURANCE GROUP" sh.a ose Sigma) është themeluar në 1999 dhe regjistruar në Gjykatën e Tiranës me Vendimin Nr.20487 me datë 3 shkurt 1999. Aktiviteti i saj rregullohet nga nenet e Ligjit Nr. 9901 me datë 14 prill 2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe Ligji Nr. 52 datë 22 maj 2014 "Për aktivitetet e sigurimit dhe risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime". Enti rregulator për tregun e sigurimeve është Autoriteti Shqiptar i Mbikqyrjes Financiare (më tej "Autoriteti"). Aktiviteti i saj kryesor është dhënia e sigurimit përmjet motorrike, pronë, shëndetin dhe sigurime të tjera jo-jetë. Në 2004 gjithashu filloj aktivitetin e saj në Kosovë nëpermjet degës së saj. Kjo degë kryesisht ofron sigurim përmjet motorrike, pronë, shëndetin dhe sigurime të tjera jo-jetë. Zyra qendrore e Shoqërisë ndodhet në adresën "Rr. Komuna e Parisit" pallatet Lura kati dy-të, Tiranë, Shqipëri.

Shoqeria kishte 248 të punësuar më 31 dhjetor 2016 (2015: 238). Efektive më 30 shtator 2014, emri i Shoqërisë u ndryshua nga Sigma VIENNA INSURANCE GROUP "sh.a në SigmaInteralbanian VIENNA INSURANCE GROUP" sh.a.

Drejtori i Menaxhimi më 31 dhjetor 2016.

Bordi Mbikqyrës	Kryetar	Bordi Drejtues	Drejtari i përgjithshëm
Z. Peter Hoefinger	Anëtar	Z. Klaidi Citozi	Zv. Drejtari i Përgjithshëm
Znj. Sonja Raus	Zv. Kryetar	Z. Enid Minarolli	Anëtar
Z. Christoph Rath	Anëtar	Z. Ervin Rali	
Z. Jonard Prodani	Anëtar		
Znj. Shefikat Ngjela	Anëtar		

2. Bazat e kontabilitetit

Pasqyrat financiare përmes raportit specifik janë përgatitur në përputhje me udhëzimet e raportimit financiar të strukturës ligjore mbikqyrëse përmjet Shqipërisë. Struktura kontabël e aplikuar është bazuar në politikat kontabëlle të detajuara në shënimin 6 i cili është bazuar në vlerësimin, prezantimin dhe parimet kontabëlle të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) me përfashtimin e mos konsolidimit të degës në juridikcionin e huaj.

3. Monedha funksionale dhe e prezantimit

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek, e cila është moneda funksionale e Shoqërisë.

4. Periudha krahuesuese

Për prezantimin më nosistent të transaksioneve, klasifikimi i zërave të caktuar në informacionin financiar krahues është ndryshuar përmes përputhje me trajtimin e vitit aktual. Riklasifikimet janë bërë si mëposhtë:

- Interesi i përllogaritur përmes depozitat me afat (shënim 12), Depozitat me afat me bankat (shënim 13), është riklasifikuar nga aktivet e tjera (shënim 21).
- Provizione përmes rasteve ligjore riklasifikohet nga shpenzime të tjera të sigurimit (shënim 33) në shpenzimet administrative (shënim 32).

5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtuesit të kryejnë gjykime, vlerësimë dhe supozime të cilat ndikojnë aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësimë. Vlerësimet dhe bazat e llogaritjes rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimet rishikohen dhe në periudha të ardhshme që rishikimi ndikon.

Më në veçanti, informacione në lidhje me vlerësimet e pasigurta dhe gjykimet profesionale në aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt të konsiderueshëm në vlerat e njohura në pasqyrat financiare përshkruhen në shënimet 14, 19, 20,23 dhe 24.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe janë bazuar në eksperiencën e mëparëshme dhe faktorë të tjera, përfshirë edhe pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme, të cilat besohet se janë të përshtatshëm dhe relevant për rrëthanat aktuale. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësimë. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë kontabël ose në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar dhe periudha të ardhshme nëse rishikimi ndikon të dyja periudhat si aktuale dhe të ardhshme.

Pretendimet dhe përfitimet e police-mbajtësit

Vlerësimi i detyrimeve që lindin nga dëme të ndodhura nga kontratat e sigurimeve është vlerësimi kontabël më kritik i Shoqërisë. Vendimi i Shoqërisë për humbjet e raportuara dhe të paraportuara dhe vendosja e rezervës dhe rimarrja nga risigurimet, rishikohen dhe përditësohen çdo vit, dhe ndryshimet që rezultojnë nga ky vlerësim pasqyrohen në humbjet ose fitimet. Proçesi nuk mbështetet në supozimin që ekspericat e mëparshme të rregullara përfshirë së cilët e zhvillimeve dhe trendave aktuale, është një bazë e besueshme përfshirë parashikimin e ngjarjeve të ardhshme.

Llogaritë e arkëtueshme të sigurimit

Llogaritë e arkëtueshme të sigurimit dhe të tjera njihen me kosto duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi. Vlerësimi i zbritjeve përfshirë humbjet nga zhvlerësimi është gjithashtu një vlerësim kritik i realizuar nga menaxhimi. Në çdo datë raportimi bëhet një vlerësim nëse llogaritë e arkëtueshme të sigurimit duhet të zhvlerësohen. Normalisht, llogaritë e arkëtueshme të sigurimit me më shumë se një vit vonesë zhvlerësohen plotësisht, më përfashtim nëse ka një probabilitet të lartë që do të arkëtohen. Ky probabilitet ekziston nëse Shoqëria ka marrëdhëniet afatgjata me klientët ose kur Shoqëria hlen të mira dhe shërbime nga i siguruari dhe të arkëtueshmet përcaktohen si shumë neto. Llogaritë e arkëtueshme të sigurimit me vonesë më pak se një vit vlerësohen individualisht në rastet kur ato kanë vlerë të konsiderueshme dhe zhvlerësohen plotësisht nëse ekzistojnë informacione që nuk do të mblidhen. Llogaritë e arkëtueshme me vonesë më pak se një vit vlerësohen gjithashtu në grup duke u bazuar në vjetërsinë e tyre. Përgindja e provigjionit që aplikohet përfshirë kategoritë vjetërsie e llogarive të arkëtueshme me vonesë më pak se një vit përfaqëson vlerësimin më të mirë të menaxhimit mbi humbjet e ardhshme dhe bazohen mbi experiencat e rimarrjes së viteve të mëparshme dhe të eksperiencave të tregut

Pronat dhe ndërtesa për investim prezantuar me vlerë të drejtë:

Një vlerësues i jashtëm vlerëson pronat e Shoqërisë, të paktën një herë në 3 vjet për pronat e rëndësishme dhe edo vit përfshirë për investim. Vlera e drejtë bazohet në vlerën e tregut, duke qënë shuma e vlerësuar përfshirë të cilën një pronë do të shkëmbohet në datën e vlerësimit midis një blerësi të vullnetshëm dhe një shitësi të vullnetshëm, në një transaksion sipas kushteve të tregut, ku palët do të kishin informacion të plotë. Megjithatë, vlerësuesit marrin në konsideratë edhe vlerën që derivon nga qasja e metodës së të ardhurave duke aplikuar normën e tregut mbi një vlerësim të vlerës së qirasë së pronës apo pronave të ngjashme.

6. Përbledhje e politikave kontabël

Politikat kontabël të përmendura më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e prezantuar në këto pasqyra financiare dhe janë aplikuar në mënyrë konsistente nga Shoqëria.

a) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike me përjashtim të aktiveve të Pronës dhë ndërtesave për investim të cilat janë të matura më vlerë të drejtë.

b) Jo-konsolidimi i degëve dhe juridiksioneve të huaja

Shoqëria vepron në Kosovë nëpërmjet degës së saj, një entitet nën zotërim dhe kontroll të plotë të Shoqërisë. Shoqëria raporton aktivitetin e degës në juridiksim të huaj në pasqyrat e saj financiare të konsoliduara duke i grupuar të gjitha transaksionet dhe balancat sikur të ishin një entitet i vetëm ekonomik. Gjithsesi, Shoqëria nuk e ka paraqitur të konsoliduar aktivitetin e degës së Kosovës në keto pasqyra financiare për raportim specifik, në mënyrë që të përbushë kërkesat e raportimit të mbikëqyrjes së sigurimeve në Shqipëri dhe në veçanti Ligji i sigurimeve kërkon që Shoqëritë e Sigurimit duhet të raportojnë pasqyra financiare individuale tek autoritetet për aktivitetet e ushtruar në Shqipëri.

c) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale të veprimtarisë sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit, kthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare të cilat janë njojur me kosto historike kthehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare të cilat janë matur me vlerë të drejtë kthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që lindin nga kurset e këmbimit njihen në të ardhura ose humbje.

d) Klasifikimi i kontratave të sigurimit (detyrimet)

Produktet e sigurimit të Shoqërisë klasifikohen fillimisht, për qëllime të kontabilitetit si kontrata sigurimi. Një kontratë, e cila klasifikohet si kontratë sigurimi mbetet e tillë derisa të gjitha të drejtat dhe detyrimet shuhën ose pushojnë së ekzistuan.

Kontratat nën të cilat Shoqëria pranon të marrë një rrezik sigurimi të rëndësishëm nga një palë tjerë (policë-mbajtësi) duke rënë dakort të kompensojë policë-mbajtësin ose përfitues të tjerë për një ngjarje të caktuar të pasigurtë (ngjarja siguruese) e cila ka efekte negative dhe ndikon në policë-mbajtësin apo përfituesit e tjerë, klasifikohet si kontratë sigurimi. Rreziku i sigurimit është i ndryshëm nga rreziku financier. Rreziku financier është rreziku i ndryshimeve të mundshme të ardhëshme në një ose më shumë nga norma interesit specifike, çmimet e letrave me vlerë, çmimet e komoditeteve, kursi i këmbimit, indekset e çmimeve ose të normave, vlerësimi i aftësisë kredituese apo indekset e kreditimit ose variabla të tjerë, të siguruar në rastin e variablate jo-financiarë kur variabli nuk është specifik për një palë në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë një pjesë të rrezikut financier.

i) Njohja dhe matja e kontratave

Kontratat e përgjithshme të sigurimit

Detyrimet e sigurimit janë llogaritur në mënyrë të vecantë për të gjitha produktet e sigurimit dhe janë të përbëra nga primet e angazhimeve të ardhshme (të pafitaura), rreziku i angazhimeve të ardhshme (të pambaruara) dhe humbjet e angazhimeve të ardhshme (të papaguara në datën e mbylljes të vitit finanziar). Detyrimet e sigurimit (provigionet) paraqesin vlerësimë të pagesave të ardhshme për dëmet e raportuara dhe të paraportuara. Shoqëria nuk i skonton detyrimet e sigurimit. Çdo ndryshim në vlerësim është reflektuar në rezultatet e operacioneve në periudhën në të cilën vlerësimet janë ndryshuar. Vlerësimi i detyrimeve të sigurimit është një proces kompleks që lidhet me pasiguritë dhe kërkon përdorimin e vlerësimeve dhe gjykimeve të informuara. Shoqëria ka përdorur kërkesat e regulatorit shqiptar të sigurimeve për të përcaktuar detyrimet e sigurimit.

6. Përbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

c) Kontratat e sigurimit (detyrimet)

(i) Njohja dhe marrja e kontratave

Prime të krijuara nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit

Primet e shkruara bruto përbëjnë shumat e detyruara gjatë vitit finanziar në përputhje me sigurimin direkt pavarësisht faktit se këto shuma mund ti përkasin plotësisht ose pjesërisht një periudhe kontabël të mëpasshme. Primet prezantohen bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj ndërmjetesve dhe nuk përfshijnë tatumet dhe detyrime doganore të bazuara tek primet. Primet janë fituar që nga data e lidhjes me rrezikun, për periudhën e dëmshpërlimit, në bazë të rrezikut të nënshkruar.

Rezerva për primin e pasituar

Rezerva e primit të pasituar në të gjitha segmentet e biznesit përfshin atë pjesë të primeve të shkruara bruto e cila vlerësohet të fitohet në vitin finanziar pasardhës, duke përdorur metodën ditore në bazë proporcionale 1/365, e rregulluar nëse nevojitet në mënyrë që të reflektojë çdo ndryshim të ndodhjes së rrezikut gjatë periudhës së mbuluar nga kontrata.

Megjithatë të gjitha produktet e Shoqërisë kanë rrezik linear dhe asnjë rregullim për ndryshime të rrezikut nuk është bërë.

Primi i pasituar është ajo pjesë e primit e cila lidhet me periudha pas datës së raportimit. Primi i pasituar llogaritet nga primet e nënshkruara të cilat prezantohen bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj ndërmjetesve dhe përfashtojnë tatumet dhe detyrimet doganore të bazuara tek primet. Kostot e shtyra të marrjes në sigurim nijilen më vete si aktive.

Kostot e shtyra të marrjes ne sigurim

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim janë pjesa e kostove të marrjes në sigurim të cilat zbriten gjatë llogaritjes së rezervës së primit të pasituar. Ato përcaktohen si pjesë e kostove të blerjes të vendosura si përqindje në planin teknik të sigurimit dhe lidhen me periudhën midis fundit të periudhës së raportimit dhe datës së shuarjes së kontrates së sigurimit. Kostot aktuale të marrjes ne sigurim dhe të ardhurat nga komisionet e risigurimit nijilen si shpenzime dhe të ardhura në periudhën aktuale.

Dëmet të krijuara nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit

Dëmet e ndodhura përbëhen nga kostot e mbylljes dhe trajtimit të dëmeve të paguara dhe të papaguara që lindin nga ngjarje të ndodhura gjatë vitit finanziar sëbashku me rregullime të provigionit të dëmeve të vitit të mëparshëm. Dëmet e papaguara vlerësohen duke rishikuar dëmet individuale dhe duke provigionuar dëmet e ndodhura por ende të paraportuara, efekti i ngjarjeve të parashikuara të brendëshme dhe të jashtëme, të tillë si ndryshimet e procedurave në trajtimin e dëmeve, inflacioni, tendencat juridike, ndryshimet legislative dhe eksperienta e mëparëshme. Provigioni për dëmet e papaguara nuk skontohet. Rregullimet për provigionin e dëmeve të viteve të mëparëshme reflektohen në pasqyrat financiare të periudhës në të cilën bëhen rregullimet dho paraqiten më vete nëse janë materiale. Ndërkohë që Bordi i Drejtoreve konsideron se detyrimet e sigurimit për dëmet dhe marrjet nga risigurimi janë të drejta, detyrimi përfundimtar mund të ndryshojë si rrjedhojë e informacioneve dhe ngjarjeve të mëvonshme dhe mund të rezultojë në një rregullim të shumës së dhënë. Rregullimet për detyrimet e sigurimit reflektohen në pasqyrat financiare në periudhën në të cilën bëhet rregullimi.

Angazhimet për dëmet në proces gjyqësor

Një pjesë e konsiderueshme e dëmeve janë në proces gjyqësor dhe për të cilat Shoqëria ka rregjistruar detyrimin përkatës në bazë të vlerësimeve të drejtimit.

6. Përbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(e) Kontratat e sigurimit (detyrimet) (vazhdim)

(ii) Risigurimi

Shoqëria cedon primet e siguruara dhe rrezikun në rrjedhën normale të biznesit me potencialin e humbjes nelo nëpërmjet diversifikimit të rrezikut që krijuhet nga linjat e biznesit të MTPL, pasurisë, kartoni jeshil, marina dhe aviacioni, detyrimet dhe aksidentet personale.

Risigurime të tilla përfshijnë tejkalimin e humbjeve nga marreveshjet fakultative. Vetëm kontratat që përfshijnë transferimin e një pjese të konsiderueshme të rrezikut të sigurimit dhe atij kohor rregjistrohen si aktive të sigurimit. Marreveshjet e risigurimit nuk e çlirojnë shoqërinë nga detyrimet direkte ndaj policës-mbajtësit. Detyrimet e risigurimit pëfshijnë llogari të pagueshme për kontrata të Jashtme risigurimi dhe njihen si shpenzime kur u mbaron afati.

Primet e risiguruara për risigurimin e ceduar njihen si shpenzim në mënyrë që të janë konsistente me njohjen e primeve të lidhura me kontratat e sigurimit. Për sigurimin e përgjithshëm të biznesit, primet e risigurimit shpenzohen në periudhën në të cilën mbulimi i risigurimit jetet në bazë të modeleve të rrezikut të risiguruar. Pjesa e paspenzuar e primit të risigurimit të ceduar përfshihet në aktivet e risiguruara. Shuma e njohur si aktiv i risiguruar matet në mënyrë që të jetë konsistente me matjet e provigionit të mbajtur në përpunë me kontratat e sigurimit.

Llogaritë e arkëtueshme nga risigurimi pëfshijnë komisionet e risigurimit nga primet e ceduara risiguruesit dhe të arkëtueshmet nga Shoqëria risiguruese në përpunë me dëmin e paguar. Këto janë klasifikuar si llogari të arkëtueshme dhe paraqiten të veçanta, nëse ka.

Aktivet e risiguruara vlerësohen për zhvlerësim në datën e raportimit. Një aktiv konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive, si rezultat i një ngjarje të ndodhur pas njohjes fillostarte, që Shoqëria mund të mos marrë të gjitha shumat që i detyrohen dhe ngjarja ka një impakt besueshmërisht të matshëm në shumat që Shoqëria do të marrë.

(iii) Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve

Në çdo datë raportimi Shoqëria bën një test të mjaftueshmërisë të rezervave të dëmeve. Testet e para që realizohen janë Analiza e Raportit të Dëmeve dhe Analizën e Zhvillimit të provigjioneve të dëmeve. Analiza e raportit të dëmeve realizohet çdo vit në mënyrë individuale për linjat kryesore të biznesit. Llogaritjet realizohen më vete për dëmet si dhe për dëmet që përfshijnë kostot e blerjeve si dhe kosto të tjera të Jashtëme për trajtimin e dëmeve. Në realizimin e kësaj analize Shoqëria merr në konsideratë vlerësimet aktuale të fluksve monetare dalëse. Shoqëria nuk i skonton këto flukse monetare pasi pjesa më e madhe e dëmeve priten të zgjidhen brënda një viti.

Për më tepër, Shoqëria kryen çdo vit analizën e zhvillimit të provigjioneve të dëmeve për të përcaktuar metodologjinë e rezervës. Kjo analize kryhet në mënyrë të vecantë por dhe të kombinuar për RBNS (të raportuara por ende të pambyllura) dhe IBNR (të ndodhura por të paraportuara). Në rastet kur analiza paraqet parregullsi të theksuara, rregullime të caktuara i bëhen metodologjisë së rezervës. Nëse një mungesë identifikohet ajo i allokohet fitimit ose humbjes duke krijuar një provigion për rrezikun e paskaduar nga humbjet që lindin nga testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve.

(iv) Portofoli i rezervës së primeve

Kur një risigurues i ri merr pjesë në një marrëveshje me bazë vitin kontabël osc kur përfshirja në një periudhë, për një risigurues ekzistues mritet, ky funksion llogarit primin e pasituar marrë nga risiguruesi për pjesëmarje në rreziqet për të cilat primi është mbledhur por nuk është fituar ende. Hyrja e portofolit të primit në fillim të periudhës së risigurimit është pjesa e përqindjes së risigurimit të primeve të pasituarës në fillim të periudhës.

6. Përbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(f) Instrumentet Financiare

(i) Njohja

Shoqëria fillimisht njeh kreditët dhe paradhëniet, të arkëtueshmet dhe huatë në datën kur lindin të drejtat dhe detyrimet përkatëse. Të gjitha detyrimet dhe aktivet e tjera financiare nijhen fillimisht në datën e transaksionit në të cilën Shoqëria bëhet palë e detyrimeve kontraktore të instrumentit.

(ii) Klasifikimi

Shih politiken kontabël 6 (g),(h),(i),(j).

(iii) Ç'rregjistrimi

Shoqëria ç'regjistron një aktiv finanziar nëse humbet të drejtat kontraktuale mbi flukset e ardhshme të parasë ose transferon të drejtat për të marrë flukset kontraktuale të parassë nga aktivet financiare në transaksione në të cilat i gjithë reziku dhe përfitimet nga aktivet financiare është transferuar. Çdo interes nga aktivë finanziar i transferuar që është krijuar ose mbajtur nga Shoqëria nijhet si aktiv ose detyrim i veçantë.

Shoqëria ç'regjistron një detyrim finanziar kur detyrimet kontraktuale shuhën, anullohen ose maturohen. Shoqëria hyn në transaksione përmes të cilëve transferon aktivet të njohura në pasqyrat e pozicionit finanziar, por mbani ose të gjithë rezikun ose përfitimet e aktivit të transferuar ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha ose pothuajse të gjitha reziqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivet e transferuara nuk ç'registrohen nga pasqyrat e pozicionit finanziar. Transferimi i aktiveve që shoqërohet me mbajtjen e të gjitha ose pothuajse të gjitha reziqeve dhe përfitimeve përfshin për shembull, transaktionet e riborjes dhe kreditimin e letrave me vlerë.

(iv) Netimi

Aktivet dhe detyrimet financiare mund të netohen dhe tepricat neto të paraqiten në bilanc vetëm kur Shoqëria ka të drejtë ligjore për të netuar shumat dhe ka për qëllim të arkëtojë ose të mbylli aktivin apo detyrimin neto në të njëjtën kohë.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten të netuara vetëm kur lejohet nga standartet e kontabilitetit, ose përfitime dhe humbje që lindin nga transaksione me natyrë të njëjtë përgjatë aktivitetit të Shoqërisë.

(v) Matja e kostos së amortizuor

Kosto e amortizuar e një aktivi apo detyrimi finanziar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi finanziar është matur në njohjen fillestare, duke zbritur këstet e paguara, plus ose minus amortizimin kumulativ që rezulton nga përdorimi i metodës së interesit efektiv për ndonjë diferençë midis vlerës së njohur në fillim dhe vlerës në maturim si dhe humbjet nga rënia në vlerë.

(vi) Matja me vlerë të drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është bazuar në çmimet e publikuara të tregut dhe treguesve të instrumentave financiare në tregjet aktive. Për të gjithë instrumentat e tjere financiare vlera e drejtë është përcaktuar duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknika të tillë si vlera reale neto, metoda e aktualizimit të flukseve, krahasimi me instrumenta të tjera të ngjashëm për të cilat çmimet përcaktohen në tregjet aktive, si dhe modele të tjera vlerësimi.

6. Përbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(f) Instrumentet financiare (vazhdim)

(vii) Identifikimi dhe matja e rënies ne vlerë

Në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare Shoqëria vlerëson nëse ka evidecë objektive për rënien në vlerë të aktiveve financiare. Aktivet financiare pësojnë rënien në vlerë kur evidecë objektive dëshmon që një ngjarje me pasojë humbje ka ndodhur pas vlerësimit të mëparshëm të aktivit, si dho kjo ngjarje ndikon në flukset e ardhshme monetare të vlerësueshme në mënyrë të besueshme.

Shoqëria merr në konsideratë evidecë për rënien në vlerë të aktiveve financiare specifike ose në grup. Të gjitha aktivet individualisht të rëndësishme testohen veçmas për humbjen e mundshme në vlerë. Të gjitha aktivet e rëndësishme që nuk konsiderohet të kenë rënë në vlerë vlerësohen më pas kolektivisht për ndonjë rënien në vlerë që ka ndodhur por nuk është identifikuar. Aktivet që individualisht nuk janë të rëndësishme grupohen dhe vlerësohen së bashku për rënien në vlerë me aktive me karakteristika të ngjashme (të mbajtura me kosto të amortizuar).

Si evidecë objektive për rënien të mundshme në vlerë të aktiveve mund të përmendet moshlyerja në kohë apo shkelja e termave nga një debitor, ristrukturimi i një kredie/paradhenie të dhënë nga Shoqëria me terma të cilat në kushte të tjera nuk do të ishin konsideruar; tregues për salimentimin e mundshëm të një debitori ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si ndryshimi në përkeqësim në statusin e arkëtueshmërisë së një debitori ose kreditori, apo kushte ekonomike që ndikojnë në përkeqësim të grupit të aktiveve.

(g) Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to përfshijnë balancat e gjendjes në arkë, mjetet monetare të depozituara në banka të nivelit të dytë dhe investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe me maturitet deri në tre muaj ose më pak që nga momenti i blerjes.

(h) Depozita me afat

Depozitat me afat paraqiten në pasqyrën e pozicionit finansiar me shumën e principalit të tyre dhe klasifikohen sipas maturitetit. Depozitat me afat me maturitet fillostar më të vogël se tre muaj klasifikohen si ekuivalentë të mjelevë monetare, ato me maturitet midis tre dhe dy mbëdhjetë muaj klasifikohen si investime në depozita me afat.

(i) Letra me vlerë

Letrat me vlerë janë investime borxhi të cilat Shoqëria ka për qëllim dhe aftësi t'i mbajë deri në maturim dhe që janë klasifikuar si aktive të mbajtura deri në maturim. Investimet të cilat kanë pagesa fiksë ose të përcaktuara dhe të cilat synohen të mbahen deri në maturim, si rrjedhojë maten me kosto të amortizuar, minus provigjionin për rënien në vlerë. Kostoja e amortizimit llogaritet duke marrë në konsideratë ndonjë skontim ose prim në blerje.

(j) Llogari të arkëtueshme sigurimi dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerë të drejtë dhe më tej maten me kosto të amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi dhe përfshijnë paratë e mbajtura nga agjentët. Të arkëtueshmet nga sigurimi vlerësohen për zhvlerësim në çdo datë raportimi

Të tjera

Aktivet e tjera finansiare jo derivative maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus humbjet nga zhvlerësimi.

Kontabilizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare diskutohet në shënimin 6 (n)

(ii) Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është njojur me vlerë nominale.

6. Përbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(k) Njohja e të ardhurave

i) Primet

Politikat kontabël në lidhje me të ardhurat nga kontratat e sigurimit janë svaruar në shënimin 6 (e).

ii) Të ardhura nga qiraja

E ardhura nga qiraja njihet në bazë të të drejtave të konstatuara.

(l) Kostot e marrjes në sigurim dhe trajtimit të dëmeve

Kostot e marrjes në sigurim përcaktohen si kosto që lindin prej blerjes së kontravave të reja të sigurimit, përfshirë këtu kostot direkte si komisionet e blerjes dhe kostot e përpilimit të dokumentit të sigurimit, por edhe shpenzime të pënjesshme administrative të lidhura me procesimin e propozimit dhe lëshimin e policës.

Kostot e trajtimit të dëmeve konsiston në shpenzimet e jashtme të trajtimit të dëmeve dhe nuk përfshijnë shpenzime të brendshme të mbulimit të dëmeve të cilat konsiderohen të janë të parëndësishme krahasuar me kostot e jashtme. Kostot direkte të marrjes në sigurim shtyen përgjatë kohëzgjatjes së policës përmes një metode konsistente me llogaritjen e provigjionit të primit të pasituar dhe paraqiten bruto nga detyrimi përkates i sigurimit, si një aktiv. Kostot e shtyra të marrjes në sigurim amortizohen sistematikisht përgjatë kohëzgjatjes së kontratës dhe testohen për zhylërim në çdo datë raportimi. Çdo shumë që nuk rimerret konsiderohet shpenzim.

(m) Shpenzimet

i) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen kur ndodhin.

ii) Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore

Shoqëria paguan vetëm kontributet të detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat sigurojnë të ardhura pensioni për punonjësit pas daljes në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit ligjor minimal për pensionet në kuadër të juridiksonit respektiv dhe planit të kontributeve të përcaktuara. Kontributet e Shoqërisë në planin e pensionit i ngarkohen pasqyrës së humbje fitimeve kur ato ndodhin.

iii) Pagesat e qirase operative

Pagesat e bëra për qiratë operative njihen në pasqyrën humbje fitimeve me metodën lineare përgjatë kohëzgjatjes së qirasë

(n) Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat e fondeve të investuara në depozita bankare dhe fitimet nga kurset e këmbimit.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesave të huamarjeve dhe humbjet nga kurset e këmbimit. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen bruto. Të ardhurat nga interest dhe shpenzimet njihen në bazë të të drejtave të konstatuara, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

6. Përbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(o) Prona dhe pajisje

(i) Njohja dhe matja

Ndërtuesat dhë pajisjet maten me vlerë të drejtë ndërsa zëra të Pajisjeve maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar (shih më poshtë) dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. Kostoja përfshin shpenzimet që janë drejtpërdrejt të atribuueshme ndaj kostos së blerjes së aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhë punës direkte (nëse ka patur), çdo kosto tjetër drejtpërdrejt e atribuueshme që sjell aktivin në gjendjen e tij të parashikuar të punës, si dhe kostot e çmontimit dhe zhvendosjes së aktivit dhe rikthimit të vendndodhjes së tij në gjendjen e mëparshme. Kur pjesët e një aktivit kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato konsiderohen si elementë të veçantë (komponentët kryesorë) të pajisjes. Humbjet dhe fitimet nga nxjerra jashtë përdorimit të një elementi të paisjeve përcaktohen përmes krahasimit të të ardhurave të gjeneruara nga nxjerra jashtë përdorimit me vlerën e mbetur të pajisjes, dhe njihen neto brenda të ardhurave të tjera në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve

(ii) Kosto të metejshme

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbetur të elementit nëse pritet që prej këtij zëvendësimi të rrjedhin përfitime të ardhshme ekonomike për Shoqërinë dhe nëse kjo kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të riparimit të përhershëm të pajisjeve njihen në pasqyrën e të ardhura shpenzimeve kur ato ndodhin

(iii) Riklasifikimi në ndërtesa të investueshme

Kur përdorimi i një ndërtese ndryshon nga vetëpërdorimi në ndërtosë të investuar, ndërtesa matet me vlerën e drejtë dhe riklasifikohet si ndërtosë e investuar. Çdo fitim që rrjedh nga rimatja transferohet në fitim ose humbje në masën që ai mbulon një humbje nga rënia në vlerë në pronën specifike, me çdo fitim të mbetur të transferuar në të ardhurn të tjera dhe të paraqitur në rezervën e rivlerësimit në kapital. Çdo humbje transferohet direkt në fitim humbje.

(iv) Zhvlerësimi

Toka, parapagime e aktive në ndërtim nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi i ndërtesave, kategoria e përmirësimeve në infrastrukturë e të tjera aktive realizohet përmes metodës së vlerës së mbetur.

Jetëgjatësia e pritshme e aktiveve të trupëzuara për periudhën aktuale dhë krahasuese është si vijon:

Ndërtesa dhe përmirësimi të qiramarrjeve	20 vjet
Mjete motorrike	5 vjet
Kompjutera dhe Paisje zyre	5 vjet
Programe kompjuterike e aktive jo materiale (programe kompjuterike)	4 vjet

Vlera e mbetur, nëse është e rëndësishme, rivlerësohet në mënyrë të përvitshme. Përmirësimet e qiramarrjeve kapitalizohen dhe zhvlerësohen për më të voglën midis jetës së dobishme dhe kohëzgjaljes së qerasës.

(p) Ndërtesa të investueshme

Ndërtuesat e investueshmo fillimisht maten me kosto dhe ne vijim me vlerë të drejtë me çdo ndryshim të mëpasshëm të njohur në fitim ose humbje. Çdo fitim ose humbje nga shitje e ndertesave te investueshme (ilogaritur si diferenca midis të ardhurave neto nga shitja dhe vlerës kontabël neto të zërit), njihet në fitim ose humbje. Kur ndertesa te investueshme që ishte klasifikuar më parë si aktiv afatgjat i trupëzuar shitet, çdo shumë e lidhur e përfshire në rezervën e rivlerësimit transferohet në fitimet e pashpërndara.

6. Përbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(q) . Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, me përfashtim të aktiveve tatimore të shtyra, shqyrtohet në çdo datë bilanci për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë tregues për rënien në vlerë. Në qoftë se ekziston ndonjë tregues i tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperushme e aktivit.

Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera e mbartur e një aktivi ose njësia e tij e gjenerimit të mjetave monetare tejkalon shumën e tij të rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjetave monetare është grupe më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare të pavarura nga aktive dhe grupe të tjera. H umbja nga rënia në vlerë njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e një njësie gjeneruese të mjetave monetare është vlera më e lartë midis vlerës në përdorim dhe vlerës reale pasi janë zhritur kostot e shitjes. Në përllogaritjen e vlerës në përdorim, flukset e pritshme për t'u arkëtuar aktualizohen duke përdorur një normë para efektit të takësë e cila reflekton vlerësimet momentale të tregut për vlerën në kohë të parastë si edhe trisqet specifike që lidhen me aktivin.

Humbja nga zhvlerësimi e njohur në periudhat e mëparshme rishikohet në çdo datë raportimi nëse ka tregues që humbja është pakësuar ose nuk ekziston më. Humbja nga zhvlerësimi rikthehet nëse ka patur një ndryshim në vlerësimin e përdorur për të përcaktuar vlerën e realizuoshme. Humbja nga zhvlerësimi kthehet vetëm në masën, me të cilën vlera e mbartur e aktivitët nuk do të tejkalonte vlerën e mbartur të tij e cila do të ishte përcaktuar si vlera neto pas amortizimit nëse nuk do ishte njohur humbja nga zhvlerësimi.

(r) Tatimi

Shpenzimet e tatim fitimit përfshijnë tatimin aktual dhe atë të shtyrë. Këto shpenzime nijhen në humbje dhe fitime me përashtim të rasteve kur njohja bëhet direkt në kapital apo të tjera të ardhura përbledhëse.

(i) *Tatim fitimi aktual*

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi të ardhurën e tatushme të viti, duke përdorur normat në fuqi në datën e raportimit, si dhe çdo rregullim për tatimin e pagueshmët të viteve të mëparshme. Shuma totale nga tatimi aktual i pagueshmët ose i arkëtueshmët është vlera më e saktë e supozuar për tu paguar apo për tu arkëtuar e cila reflekton pasiguri në tatimin mbi të ardhurat, nëse ka. Tatim fitimi aktual matet duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet në fuqi në datën e raportimit. Tatimi aktual gjithashtu, përfshin çdo taksë që vjen nga dividentët. Tatimet nga aktivet dhe detyrimet kompsohen vetëm nëse plotësojnë disa kriterje.

(ii) *Tatimi i shtyre*

Tatimi i shtyrë është llogaritur në përputhje me diferençat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve detyrimeve për qëllime reportimi financiar dhe vlerës së perdorur për qëllime tatumore. Një aktiv tatumor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilët të mund të përdoren humbjet tatumore të papërdorura dhe kreditimet tatumore të papërdorura. Aktivet tatumore të shtyra janë rishikuar në çdo datë raportimi dhe janë pakësuar për pjesën mbi të cilën nuk është më e mundur të realizohet përsitimi fiskal. Aktive tatumore të shtyra të parnjohura rivlerosohen në çdo datë raportimi dhe njihen në masën që bëhet e mundshme që fitime të ardhshme të tatueshme dojenë të disponueshme kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Shuma e tatimit të shtyrë llogaritet në normën e tatimit që pritet të aplikohet në diferençat e përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin tatumor në fuqi ose që hyn në fuqi në datën e raportimit.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatuimore që do duhet të ndiqen nga mënyra se si Shoqëria pret, në datën e raportimit, të rekuperojë ose shlyejë vlerën e mbartur të aktiveve ose detyrimeve të veta. Aktivi tatuimor i shtyrë kompensohet me detyrimin tatuimor të shtyre vetëm në qoftë se kriteret e caktuarat përbushen.

6. Përbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(s) Standarde të reja dhe interpretime ende të pa adoptuara

Disa standarde të reja, ndryshime të standardeve ekzistuese dhe interpretimi hyjnë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë pas datës 1 janar 2016 dhe me aplikim më të hershëm të lejuar, megjithatë Shoqeria nuk ka aplikuar këto standarde dhe ndryshime në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

Ndryshimet në SNRF 11 Marrëveshjet e përbashkëta: Kontabilizimi blerjeve të interesave - Këto ndryshime nuk kanë ndonjë ndikim në Kompani pasi nuk ka pasur interes të blerë në një operacion të përbashkët gjatë periudhës.

Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 38: Saktësimi i Metodave të pranueshëme të zhvlerësimit dhe amortizimit - Ndryshimet squarejnë parimin e dhënë në SNK 16 Aktivet Afatgjata Materiale dhe SNK 38 Aktivet jo-materiale që të ardhurat pasqyrojnë një model të përfitimeve ekonomike që janë krijuara nga rrjedha e biznesit (në të cilin aktivi është pjesë) dhe jo nga përfitime ekonomike që kanë ardhur nëpërmjet përdorimit të aktivit. Si rezultat, një metodë që bazohet tek të ardhurat nuk mund të përdoret për të zhvlerësuar pronën, impiantet dhe paisjet por mund të përdoret vetëm në rrethana shumë të kufizuara për amortizimin aktive jo-materiale. Ndryshimet zbatohen në mënyrë prospektive dhe nuk kanë ndonjë ndikim në kompani, duke pasur parasysh se nuk është përdorur metoda e të ardhurave për të zhvlerësuar asetet e saj afatgjata.

Ndryshimet në SNK 1 - Dhënia e informacioneve shpjeguese - Ndryshimet në SNK 1 sqarojnë, në vend që të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme, kërkesat e SNK 1 ekzistues. Ndryshimet sqarojnë:

- Kërkesat e materialitetit në SNK 1;
- Zerat specifike në deklaratën (at) e fitimit ose humbjes e të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe pasqyrën e pozicionit financiar, mund të ndahen;
- Se subjektet kane fleksibilitet për sa i përket rendit në të cilën ata paraqesin shënimet për pasqyrat financiare
- Që pjesa e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse nga pjesëmarjet dhe sipërmarrjet e përbashkëta të kontabilizuara duke përdorur metodën e kapitalit neto duhet të paraqiten në total si një zë, dhe të klasifikohen mes atyre zërave që do apo nuk do të riklasifikohen në fitim ose humbje.

Për më tepër, ndryshimet qartësojnë kërkesat që zbatohen kur janë paraqitur nën-totale shtesë në pasqyrën e pozicionit financiar dhe deklaratën (at) e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjern gjithëpërfshirëse. Këto ndryshime nuk kanë ndonjë ndikim në kompani.

(t) Standarte dhe interpretime të publikuara por që nuk janë ende ne fuqi

Standardet dhe interpretimet e publikuara, por që nuk janë ende ne fuqi, deri në datën e lëshimit të pasqyrave financiare të kompanisë janë shpalosur më poshtë. Kompania synon ti aplikojë këto standarde, nëse aplikohen, kur ato të hyjnë në fuqi

SNRF 9 Instrumentet Financiare – Në korrik 2014, BSNK, ka publikuar versionin final të SNRF 9 Instrumentet Financiare që zëvendëson udhëzimin ekzistues të SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Vlerësimi dhe te gjitha versionet e tjera te SNRF 9. SNRF 9 sjell se bashku të tre aspektet e kontabilitetit per instrumentet finansiar: klasifikimin dhe vlerësimin, çvlerësimin, dhe kontabilitetin mbrojtës. SNRF 9 hyn në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2018 dhe zbatimi i mëhershëm është i lejuar. Shoqëria është duke vlerësuar ndikimin e mundshëm në pasqyrat e saj financiare që rezultojnë nga zbatimi i SNRF 9. Përveç për kontabilitetin mbrojtës, zbatimi retrospektiv nuk është i detyrueshëm përmund te kryhet duke siguruar dhe informacionin krahasues. Për kontabilitetin mbrojtës, kërkesat janë aplikuar në përgjithësi në mënyrë prospektive, me disa përjashtime.

Kompania ka në plan të miratojë standardin e ri në datën e hyrjes ne fuqi. Kompania është në një proces vlerësimi të nivelit të lartë per ndikimin e tërë aspekteve të SNRF 9. Ky vlerësim paraprak është i bazuar në informacionin e disponueshëm aktualisht dhe mund të jetë subjekt i ndryshimeve që rrjedhin nga analizat e mëtejshme të hollësishme ose informacione shtesë të arsyeshme që vihen në dispozicion të kompanisë në të ardhmen. Kompania është duke vlerësuar ndikimin e mundshëm në pasqyrat e saj financiare që rrjedhin nga zbatimi i SNRF 9. Duke pasur parasysh natyrën e operacioneve të kompanisë, ky standard nuk pritet të ketë një ndikim të konsiderueshëm në pasqyrat financiare të kompanisë.

6. Përbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(f) Standarte dhe interpretime te publikuara por që nuk jane ende ne fuqi (vazhdim)

SNRF 9 Instrumentet Financiare (vazhdim)

(a) Klasifikimi dhe matja - Kompania nuk pret një ndikim të rëndësishëm në bilancein e saj ose në kapital nga aplikimi klasifikimit dhe matja sipas kërkjesave të SNRF 9. Ajo pret që të vazhdojë të masë me vlerën e drejtë të gjitha aktivet financiare që aktualisht mbahen me vlerën e drejtë. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme janë mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe pritet të jasin tritje të flukseve të mjeteve monetare që përfinqësojnë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit. Kështu, kompania pret që këto do të vazhdojnë të maten me koston e amortizuar në bazë të SNRF 9. Megjithatë, kompania do të analizojnë karakteristikat e flukseve monetare të këtyre instrumenteve në mënyrë më të detajuar para se të sigurohet nëse të gjitha këto instrumente përbushin kriteret për matjen koston e amortizuar sipas SNRF 9.

(b) Cylorësimi - SNRF 9 kërkon që kompania të regjistrojë humbjet e pritshme të kredisë në të gjitha letrat me vlerë të borxhit të saj, huatë dhe llogaritë e arkëtueshme, mbi një bazë 12-mujore ose gjithë jetës. Kompania pret që të zbatojë qasjen e thjeshtuar duke njohur humbjet pritshme e të gjithë jeten në të gjitha llogarive të arkëtueshme. Kompania pret një ndikim të rëndësishëm në kapitalin e saj për shkak të natyrës së pasiguruar të huave dhe llogarive të arkëtueshme të saj, por ajo do të duhet të kryejë një analizë më të detajuar e cila do konsideroje të gjitha informacionet e arsyeshme dhe të mbështetura, duke përfshirë elementet largpamës për të përcaktuar shkallën e ndikimit.

SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët - SNRF 15 u publikua në maj 2014 dhe krijuen një model me pesë-hapa për të ardhurat që rrjedhin nga kontratat me konsumatorët. Sipas SNRF 15, të ardhurat njihen në një vlerë që pasqyron konsideratat që njësia ekonomike pret të drejtën në këmbim për transferimin e mallrave ose shërbimeve për një klient. Standardi i ri i të ardhurave do të zëvendësojë të gjitha kërkësat aktuale njohjen e të ardhurave nën SNRF. Ose një aplikim i plotë retrospektiv ose një aplikim i modifikuar retrospektiv është e nevojshëm për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018, kur BSNK te përfundojë ndryshimet për të shtyrë datën efektive të SNRF 15 dhe një vit. Miratimi i hershëm është i lejuar. Kompania është duke vlerësuar ndikimin e mundshëm në pasqyrat e saj financiare që rrjedhin nga zbatimi i SNRF 15.

SNK 7 Dhënia e informacioneve shpjeguese – Ndryshimet në SNK 7 - Ndryshimet në SNK 7, Pasqyra e rrjedhës së parasë, janë pjesë e dhënieve së informacioneve shpjeguese të BSNK-së dhe kërkojnë që njësia ekonomike të japë informacione shpjeguese që mundusojnë përdoruesit e pasqyrave financiare të vlerësojnë ndryshimet në detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet financuese, duke përfshirë dy ndryshimet që rrjedhin nga flukset e mjeteve monetare dhe ndryshimet jo-monetare. Në aplikimin filletar të amendamentit, subjektet nuk janë të detyruara për të siguruar informacion krahues për periudhat paraardhese. Këto ndryshime janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2017, ku zbatimi i hershem është i lejuar.

SNRF 16 Qirate - SNRF 16 është publikuar në janar 2016 dhe zëvendëson SNK 17 Qiratë, KIRFN 4 Përcaktimi nëse një marrëveshje përban një qera, KIS-15 Qiratë e Zakonshme dhe KIS-27 Vlerësimi i Përbajtjes së Transakstioneve që Përfshijnë Formën Ligjore të një qirasë. SNRF 16 përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe dhëni e informacioneve të qirave dhe kërkon qiramarrësit të jalin llogari për të gjitha qiratë në hilancë të ngjashme me kontabilizimin e qirave financiare sipas SNK 17. Standardi përfshin dy përgjashtime njohjes për qiramarrësit - qiratë e aktiveve "me vlerë të ulët" (p.sh., kompjutera personale) dhe qiratë afat-shkurtër (p.sh., qiratë me afat prej 12 muajsh ose më pak). Në datën e fillimit të qirasë, qiramarrësi do të njohë një pasiv për përfshirë pagesat e qirasë (dmth përgjegjësi qira) dhe një aset që përfraqëson të drejtën e përdorimit të aktivit të themelor gjatë afatit të qirasë (p.sh., e drejta e përdorimit të pasurisë). Qiramarrësi do të kërkohet të njohë veçmas shpenzimet e interesit mbi pasivin qirasë dhe shpenzimet e amortizimit për aktivin me të drejtë përdorimi. Qiramarrësi do t'u kërkohet edhe për të rimësë detyrimin qirasë pas ndodhjes së ngjarjeve të caktuara (p.sh., një ndryshim në afatin e qirasë, ndryshim në pagesat e ardhshme të qirasë që ndodhin nga një ndryshim në indeks ose norma që përdoren për të përcaktuar këto pagesa). Qiramarrësi në përgjithësi do të njohë shumën e rimatur të detyrimit të qirasë si një rregullim në aktivin me të drejtë përdorimi.

Kontabilizimi i qeradhënsit sipas SNRF 16 është në thelb i pandryshuar nga SNK 17. SNRF 16 kërkon gjithashu që qiramarrësit dhe qiradhënsit të jasin me shume informacion se sipas SNK 17.

SNRF 16 hyr në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019. Aplikimi i hershëm është i lejuar, por jo para se njësia ekonomike të zbatojë SNRF 15. Qiramarrësi mund të duke përdorur në retrospektivë të plotë apo një qasje retrospektive të modifikuar. Dispozitat kalimtare standardi lejojnë këto lehtësira. Në vitin 2017, kompania ka në plan të vlerësoje efektin e mundshëm të SNRF 16 në pasqyrat e saj financiare.

7. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Shoqëria bën vlerësimë dhe supozime që ndikojnë shumat e reportuara të aktiveve dhe detyrimeve gjatë vitit financiar. Vlerësimet dhe gjykimet çmohen në mënyrë të vazhdueshme dhe bazohen në informacionin e vlefshëm relevant të tregut dhe në faktorë të tjera, duke përfshirë këtu pritshmëritë përgjegjje të ardhshme që besohen si të arsyeshme nën rrethanat e dhëna

(i) Llogaritja e Detyrimeve të Sigurimit

Shiko shënimin 6 (e).

(ii) Njoftja e detyrimit ligjor të Fondit të Kompensimi TPL

Shiko shënimin 37.

(iii) Përcaktimi i Vlerës së Drejtë

Politikat kontabël të Shoqërisë mbi llogaritjen e vlerës së drejtë diskutohen në politikat kontabël 5.f (vi). Shoqëria llogarit vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të vlerës së drejtë që reflekton rëndësinë e inputeve të përdorura në kryerjen e llogaritjeve:

- Niveli 1: Çmimi i tregut i kuotuar (i parregulluar) në një treg aktiv për një instrument identik
- Niveli 2: Teknika të vlerësimit të bazuar në inputet e observuara, qoftë direkt (p.sh. çmimet) qoftë indirekt (p.sh. të derivuar nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumenta të vlerësuar duke përdorur çmimet e kuotuara në tregjet aktive për instrumenta të ngjashëm; çmimet e kuotuara për instrumenta identikë ose të ngjashëm në tregje më pak se aktive; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjitha inputet e rëndësishme janë të observueshme direkt ose indirekt nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Teknika të vlerësimit që përdorin inpute të rëndësishme të paobservueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentat për të cilët teknikat e vlerësimit janë bazuar në inpute të paobservueshme dhe ku inputet e paobservueshme kanë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumenta që vlerësohen bazuar në çmimet e kuotuara të instrumentave të ngjashëm ku rregullime apo supozime të rëndësishme të paobservueshme reflektojnë diferenca midis instrumentave.

Teknikat e vlerësimit përfshijnë modelet e vlerës aktuale neto dhe te flukseve të skontuara të parasë, krahasimin me instrumenta të ngjashëm për të cilët ekzistojnë çmime tregu të observueshme dhe bazuar në një kurbë të përshtatshme të normës korrente të interesit për kohën e mbetur deri në maturim. Supozimet dhe inputet e përdorura në teknikat e vlerësimit marrin parasysh normat me risk zero dhe normat bazë të interesit, spread-et e kredisë dhe prime të tjera të përdorura në vlerësimin e normave të skontos, çmimet e obligacioneve dhe të kapitalit, kurset e këmbimit të monedhave të huaja, kapitalin dhe çmimet e indeksuara të kapitalit dhe luhatjet apo korrelimet e pritura të çmimeve. Objektivi i teknikave të vlerësimit është që të arrihet të përcaktohet vlera e drejtë që reflekton çmimin e instrumentit financiar në datën e raportimit, vlerë e cila do të ishte përeactuar nga pjesëmarrësit e tregut në kushtet e një transaksioni të kryer në mënyrë të vullnetshme midis palëve të palidhura me njëra tjeter.

(iv) Përllogarija e tatimit mbi fitimin e koorporatës

Menaxhimi beson se llogaritja e tatimit mbi provigjionin e fitimit është e përshtatshme duke marrë parasysh pasigurinë e njësive ligjor shqiptar dhe legjislacionin ekzistues në fuqi dhe qëdo auditim tatimore i ardhshëm nuk do të ketë një efekt domethënës në pozicionin financiar të Shoqërisë, në rezultatet e operacioneve apo në flukset e parasë. Sidoqoftë, bazuar dhe në nalyren e ligjit për tatim fitimin, praktikat e lidhura dhe udhëzimet nuk eshte e mundur te percaktohet me saktesi që pozicioni ligjor i tatimit aktual do te qëndrojë i pakundërshtueshëm nga autoritetet tatimore.

SigmalInteralbanian Vienna Insurance group sh.a.
Shënimë shpjeguese të pasqyrave financiare
(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek' 000, përvçese kur përcaktohet ndryshe)

8. Administrimi i Rrezikut Financiar

Shoqëria monitoron dhe menaxhon rrezikun financiar që lidhet me operacionet e saj përmes analizave të brendshme të riskut të cilat përshkruajnë shkallën dhe rëndësinë e riskut. Këto risqe përfshijnë riskun e tregut (risku i monedhës, risku i normave të interesit), riskun e kredisë dhe riskun e likuiditetit. Shoqëria nuk përdor instrumenta financiare derivativë për t'u mbrojtur nga ekspozimini ndaj këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku i një impakti financiar negativ si rrjetohojë e ndryshimeve të tregut të tillë si ndryshimet në kurset e këmbimit, në normat e interesit dhe ndryshime të tjera në çmime. Risqet e tregut krijohen për shkak të luhatjeve si në vlerën e aktiveve ashtu edhe të detyrimeve të mbajtura. Shoqëria ka përcaktuar politika dhe procedura për menaxhimin e riskut të tregut.

Risku i monedhës

Shoqëria ndërmerr transaksione si në monedhën lokale ashtu edhe në monedha të huaja; ndaj edhe lind rreziku prej luhatjes së kurseve të këmbimit. Për këtë arsy, luhatjet në kurset e këmbimit të monedhave të huaja mund të ndikojnë nivelin e kapitalit të aksionerëve si rezultat kjo i përkthimit të tij në monedhën lokale. Risku i monedhës në portofolin e investimeve menaxhohet përmes përdorimit të parimit të përpulishmërisë së aktiveve me detyrimet. Normal zyrtare sipas Bankës Qendrore (Lek për njësi të monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2016		31 dhjetor 2015	
	Mesatare	Në myllje	Mesatare	Në myllje
Dollari amerikan (USD)	124.52	128.17	126.46	125.79
Njesia e monedhes BE (EUR)	137.36	135.23	139.64	137.28

Aktivet dhe Detyrimet e Shoqërisë sipas monedhave në 31 dhjetor 2016 janë si më poshtë:

(Të përkthyera në Lek)	Në Lek	Në EUR	Në USD	Totali
Aktivet				
Mjete monetare dhe ekivalente	117,599	34,862	12,256	164,717
Depozita me asfat në bank	602,394	230,137	-	832,531
Bono Thesari	956,465	88,848	-	1,045,313
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera, neto	96,220	74,007	5,143	175,369
Aktive të risiguruesve	654,664	572,453	6,371	1,233,488
Aktive të tjera	37,293	91,972	-	129,265
Totali i aktiveve financiare	2,464,635	1,092,279	23,770	3,580,683
Detyrimet				
Provigionë të kontratave të sigurimit	1,565,571	822,430	14,023	2,402,024
Të pagueshme të sigurimeve dhe të tjera	679,653	302,668	3,696	986,017
Detyrime per taksa dhe të tjera	32,061	-	-	32,061
Totali i detyrimeve financiare	2,277,285	1,125,098	17,719	3,420,102
Pozicioni neto në monedhë të huaj	187,350	(32,819)	6,051	160,581

SigmaInteralbanian Vienna Insurance group sh.a.
Shënimë shpjeguese të pasqyrave financiare
(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek' 000, përvçëse kur përcaktohet ndryshe)

8. Administrimi i Rrezikut Financiar (vazhdim)

Aktivet dhe detyrimet e Shoqërisë të shprehura në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

(Të përkthyer në Lek)	Në Lek	Në EUR	Në USD	Totali
Aktivet				
Mjete monetare dhe ekivalente	33,908	18,349	7,854	60,111
Depozita me afat në bank	657,547	285,113	13,791	956,631
Bono Thesari	942,371	91,713	-	1,034,084
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera, neto	69,039	111,872	10,132	191,043
Aktive të risiguruesve	705,778	758,944	9,435	1,474,157
Aktive të tjera	37,846	76,938	59	114,843
Totali i aktiveve financiare	2,446,489	1,342,929	41,451	3,830,869
Detyrimet				
Provizione të kontratave të sigurimit	1,530,807	931,325	161,209	2,623,341
Të pagueshme të sigurimeve dhe të tjera	638,229	362,969	4,826	1,006,024
Detyrime per taksa dhe të tjera	15,298	-	-	15,298
Totali i detyrimeve financiare	2,184,334	1,294,294	166,035	3,644,663
Pozicioni neto në monedhë të huaj	262,155	48,635	(124,584)	186,206

Risku i kredisë

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve të ardhshme monetare të një instrumenti financiar do të luhatet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe nga risku që maturitetet e aktiveve që mbartin interes do të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes dhe që janë përdorur për të financuar këto aktive. Kohëzgjatja brenda së cilës norma e interesit e një instrumenti financiar qëndron e liksuar përcakton edhe shkallën e riskut të normës së interesit ndaj të cilil ekspozohet instrumenti. Më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 Shoqëria nuk ka pasur detyrime të rëndësishme interesimbajtëse, ndaj edhe nuk ka përqëndrim të rëndësishëm të riskut të normave të interesit.

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Instrumente me norma fiksë		
Aktive financiare		
<i>Depozita me afat</i>	832,531	956,631
<i>Bono thesari</i>	1,045,313	1,034,084
Total	1,887,844	1,990,715

3. Administrimi i Rrezikut Financiar (vazhdim)

Analiza e sensitivitetit

Një ndryshim në 100 pikë e normës së interesit do të rrisë ose zgjelojë kapitalin me 16,742 mijë Lek pas tatim fitimit (2015: 16,742mijë lek). Kjo analizë supozon se të gjithë variablat e tjerë, në normat e vçantë të këmbimit në monedhë të huaj, mbeten konstante.

Tabela në vijim tregon me detaje ndjeshmérinë e kompanisë në rritje dhe zvogëlim të lekut kundrejt valutave më të rëndësishme. Ky ndryshim në kurset e këmbimit është përdorur kur raportohet rrezikun e monedhës të huaj brenda vendit për personelin drejtues kryesor dhe paraqet vlerësimin e drejtimit të ndryshimit të arsyeshëm të mundshëm në kurset e këmbimit. Për çdo analizës së ndjeshmërisë ndikimi i ndryshimit në një faktor të vetrëm është treguar, me supozimet e tiera të pandryshuara.

Analiza e sensitivitetit për vitin e mbyllur me
31 dhjetor 2016 31 dhjetor 2015

		SI unjetor 2010		SI unjetor 2011	
	rritet (% bie) përkundrejt Lekut	Fitim	Humbje	Fitim	Humbje
EUR	10%/(10%)	3,282	(3,282)	4,864	(4,864)
USD	10%/(10%)	605	(605)	12,458	(12,458)

Risku i kredīsē

Risku i kredisë i referohet riskut që pala tjetër do të dështojë në obligimet e saj kontraktuale duke rezultuar në humbje financiare për Shoqërinë. Përgjatë ecurisë normale të biznesit, teksa arkëtohen primet, këto fonde investohen për të shlyer obligimet e ardhshme të pollicave. Shoqëria ekspozohet ndaj riskut të kredisë përmes titujve të borxhit të mbajtur deri në maturim, depozitave me afat, të arkëtueshmeve të sigurimit dhe kundërpartitë e risigurimit. Shoqëria ka vendosur procedura të brendshme dhe udhëzime sipas të cilave partnerët e risigurimit duhet të kenë vlerësimo BBB- ose më të larta NGA S&P, Moody ose AM Best dhe risku monitorohet nga stafi përgjegjës për risigurimet. Shoqëria menaxhon ekspozimin ndaj riskut të kredisë në mënyrë të rregullt përmes monitorimit të ekspozimit ndaj titujve të borxhit dhe kundërpartitë e depozitave me afat.

Shoqëria menaxhon ekspozimin ndaj riskut të kredisë në mënyrë të rregullt duke monitoruar vazhdimit të arkëtueshmet nga sigurimet. Këto të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 sipas vjetërsisë paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016			
	Bruto	Zhvlerësimi	Neto	%
I to 3 muaj	68,748	-	68,748	39.20
3 muaj deri në 1 vit	57,708	(3,542)	54,166	30.90
më shumë se një vit	317,016	(264,560)	52,455	29.90
Total	443,472	(268,102)	175,369	100

	31 dhjetor 2015			
	Bruto	Zhvlerësimi	Neto	%
I to 3 muaj	61,044	-	61,044	32.0
3 muaj deri në 1 vit	84,133	(4,330)	79,803	41.8
më shumë se një vit	312,668	(262,472)	50,196	26.3
Total	457,845	(266,802)	191,043	100

8. Administrimi i Rrezikut Financiar (vazhdim)

Risku i kredisë (vazhdim)

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 vlerësimi për riskun e kredisë nga primet e ceduara të risigurimit dho aktivet e risigurimit bazuar në vlerësimin e risiguruesve është si më poshtë :

	2016				2015			
	Prime të ceduara		Aktive të risigurimi		Prime të ceduara		Aktive të risigurimi	
	'000 Lek	% of total	'000 Lek	% of total	'000 Lek	% of total	'000 Lek	% of total
Vlerësimi								
AA	15,300	1.7	11,110	0.9	18,032	1.7	12,941	0.9
AA-	14,072	1.5	29,844	2.4	25,320	2.3	43,334	2.9
A+	861,458	94.4	1,152,088	93.4	1,014,196	93.1	1,359,682	92.2
A	12,303	1.3	19,732	1.6	24,421	2.2	26,005	1.8
A-	9,275	1.0	20,714	1.7	7,737	0.7	10,195	0.7
Padisponueshëm	88	-	-	-	-	-	22,000	1.5
Total	912,496	100	1,233,488	100	1,089,706	100	1,474,157	100

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria nuk do të përbushë obligimet e saj që lidhen me detyrime financiare brenda periudhës kur duhet të shlyhen. Risku i likuiditetit është një risk i moderuar i brendshëm për aktivitetin e biznesit të Shoqërisë sepse disa prej aktiveve të blera dhe detyrimeve të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqëria do t'ë kërkonte shuma të konsiderueshme brenda një periudhcë të shkurtër duke tejkaluar kërkesat normale për mjete monetare, ajo mund të përballej me vështirësi për të siguruar çmime tërheqëse. Pavarësisht kësaj, Shoqëria ka akses në huamarrje më 31 dhjetor 2016 dhe 2015. Shoqëria menaxhon riskun e likuiditetit përmes monitorimit të vazhdueshëm të fluksit të parasë të parashikuar dhe atij aktual, duke përputhur maturitetet e aktiveve dhe detyrimeve financiare.

Aktivet dhe detyrimet financiare më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 të detajuara sipas maturitetit paraqiten më poshtë:	Më pak se 3 muaj	Midis 3 muaj dhe 1 vit	Midis 1 vit dhe 5 vjet	Totali
Aktivet				
Mjete monetare dhe ekuivalentë	164,717	-	-	164,717
Depozita me asfat me bankat	117,243	643,970	71,318	832,531
Bono thesari	71,579	54,707	918,848	1,045,313
Të arkütueshme nga sigurimet dhe të tjera, neto	95,604	79,756	-	175,369
Aktive të risigurimit	69,799	509,886	653,802	1,233,488
Aktive të tjera	18,167	69,452	41,646	129,265
Totali i aktiveve financiare	537,289	1,357,780	1,685,614	3,580,683
Detyrimet				
Provigionë të kontratave të sigurimit	349,310	863,333	1,189,381	2,402,024
Taksa e detyrime të ngjashme	32,061	-	-	32,061
Llogari të pagueshme e të tjera	288,612	286,971	410,434	986,017
Totali i detyrimeve financiare	669,983	1,150,304	1,599,815	3,420,102
Pozicioni i likuiditetit neto	(132,694)	207,476	85,799	160,581
Pozicioni kumulativ	(132,694)	74,782	160,581	-

SigmaInteralbanian Vienna Insurance group sh.a.
Shënimë shpjeguese të pasqyrave financiare
(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek '000, përvçese kur përcaktohet ndryshe)

8. Administrimi i Rrezikut Financiar (vazhdim)

Aktivet dhe detyrimet financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2015 kanë maturitetet e mëposhtme:

	Më pak se 3 muaj	Midis 3 muaj dhe 1 vit	Midis 1 vit dhe 10 vjet	Totali
Aktivet				
Mjete monetare dhe ekivalente	60,111	-	-	60,111
Depozita me afat me bankat	128,377	732,753	95,567	956,697
Bono thesari	175,067	95,001	763,969	1,034,037
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera, neto	191,043	-	-	191,043
Aktive të risigurimit	222,918	427,023	824,216	1,474,157
Aktive të tjera	47,377	57,177	10,222	114,776
Totali i aktiveve financiare	676,126	1,529,156	1,625,587	3,830,869
Detyrimet				
Provijione të kontratave të sigurimit	500,011	655,914	1,467,416	2,623,341
Taksa e detyrime të ngjashme	15,298	-	-	15,298
Të pagueshme të sigurimeve e të tjera	293,426	314,918	397,680	1,006,024
Totali i detyrimeve financiare	808,735	970,832	1,865,096	3,644,663
Pozicioni i likuiditetit neto	(132,609)	558,324	(239,509)	186,206
Pozicioni kumulativ	(132,609)	425,714	186,206	-

Manazhimi i riskut të kapitalit

Struktura e kapitalit të Shoqërisë konsiston në kapital që i atribuohet mbajtësve të kapitalit të Shoqërisë, dhe përfshin kapitalin e paguar, rezervat dhe fitimin e mbajtur. Shoqëria menaxhon kapitalin për të siguruar që çdo vendndodhje të mbajë nivelet e këruara të kapitalit që siguron vijimësinë e aktivitetit dhe përputhshmérinë me kërkesat për kapital të rregulatorëve, ndërsa maksimizon kthimin ndaj aksionerëve përmes optimizimit të raportit të borxhit me kapitalin. Më 31 dhjetor 2016, aftësia paguese eshte në nivelin e këruar sipas ligjin për sigurime.

Rreziqe të tjera

Ndryshimet në rregulloret shtetërore për segmentet e biznesit në të cilat Shoqëria operon mund të prekin përfitueshmérinë e saj. Biznesi i sigurimeve është subjekt i mbikqyrjeve gjithëpërfshirëse dhe zhvilluese. Qëllimi kryesor i këtyre rregulloreve është mbrojtja e policembajtësve. Ndryshimet në ligjet dhe rregulloret aktuale të sigurimit mund të ndikojnë mënyrën me të cilën Shoqëria drejton aktivitetin e biznesit dhe produktet që ofron. Për më tepër, përshtatja dhe amendimi i herë pas hershëm i ligjeve të sigurimit ose rregulloreve mund t'i bëjë ato më kufizuese ose të rezultojnë në kosto më të larta sesa kërkesat korrente.

9. Administrimi i rrezikut të sigurimit

Shoqëria merr mbi vete rrezik të sigurimit përmes kontratave të sigurimit në të cilat merr parasysh rrezikun e humbjes nga personat apo organizatat që janë drejtpërdrejt subjekt i humbjes. Shoqëria është e ekspozuar ndaj pasigurisë që ka të bëjë me kohën, frekuencën dhe shkallën e dëmeve të lidhura me këtë kontrata.

